

URDHËR
Nr. 223, datë 26.7.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 90, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike falas z. Ergys Qirici, te drejtori i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse, znj. Lefkothea Lite, për periudhën 1 gusht 2022 deri më 10 gusht 2022.
 2. Kompetencat e deleguara të titullarit do të ushtrohen përgjatë periudhës së pamundësisë së ardhjes në punë të drejtorit të përgjithshëm, si rezultat i kryerjes së lejes vjetore.
 3. Në kompetencat e deleguara nuk përfshihen kompetencat e nëpunësit autorizues të institucionit për veprimet pranë Degës së Thesarit Tiranë.
 4. Ngarkohet znj. Lefkothea Lite për zbatimin e këtij urdhri, Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri, si dhe të gjithë punonjësit për zbatim.
- Ky urdhër hyn në fuqi më datë 1.8.2022 dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ergys Qirici